
DOKUMENTE E MATERIALE

**DY DOKUMENTE TË PANJOHURA MBI JETËN
E POETIT NEZIM BERATI
(SHEK. XVIII)**

Nezim Berati, është poeti për të cilin është shkruar dhe botuar më shumë nga poetët shqiptarë të shekullit XVIII të cilët shqipen e shkruan me alfabetin arab. Jeta e tij ndonëse ka filluar të ndriçohet që me botimin klasik të George von Hahn-it *Studime shqiptare*,¹ mbetet sërish plot me paqartësi. Madje edhe saktësia e të dhënave të publikuara deri më tani vihet në pikëpyetje si nga vetë krijimtaria e Nezimit, e cila në shumicën e rasteve ka edhe nota biografike, ashtu edhe nga dokumentacioni i kohës, i parë jo në mënyrë të shterueshme. Këto paqartësi janë reflektuar edhe në vetë emrin e poetit, i cili megjithëse asnjëherë nuk është bërë temë debati, ka njohur formulime të ndryshme në kohëra të ndryshme; deri në vitet '50 të shekullit të kaluar ai njihet me emrin Nezim Berati, kurse më pas për të do të përdoren emrat, Ibrahim Nezimi dhe Nezim Frakulla.

Në këtë artikull do të parashtroj dy dokumente të panjohura deri më tani, me të dhëna të reja mbi jetën dhe emrin e poetit, e thënë ndryshe mbi identifikimin e vendlindjes së tij dhe emrit që ai ka përdorur në dokumentet zyrtare të kohës. Ato janë dokumentet zyrtare të dy martesave që Nezimi ka kryer mes viteve 1748-1752, të cilat gjenden në regjistrat e Gjykatës së Sherijes të qytetit të Beratit, në Arkivin Qendror të Shtetit, Tiranë.² Martesën e parë Nezimi e ka kryer në vitin 1162 hixhri (1748-9) me Ismihanin nga Peqini, kurse martesën e dytë, tri vjet më vonë, më 1165 hixhri (1751-2) me Hatixhenë nga Bobrati. Nga dokumentacioni i gjetur deri më tani nuk dihen arsyet se përse ka kryer dy martesa dhe kjo mbetet një çështje e hapur për kërkime të mëtejshme. Ajo që mund të them me siguri është se statusi social i gruas së dytë (Hatixhesë nga Bobrati) ka qënë ka qënë më i lartë se i të parës. Kjo bëhet e qartë nga shuma e paguar për martesë, bashkëshoqërimi i saj me pajë, por edhe nga që përfaqësues i poetit në këtë procedurë zyrtare është myftiu i Beratit, Ataullah

¹ Johan Georg von Hahn, *Albanesische Studien*, Heft 2, Jena: Fr. Mauke, 1853, f. 142-146.

² Arkivi *Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSh*), Fondi 128 (Sherie e Beratit), Dosja 5, fl. 8b dhe 56a.

Efendiu.* Më poshtë po jap tekstin e përkthyer në shqip të dy dokumenteve, kurse tekstin origjinal në turqishten osmane, në Apendikset bashkangjitur këtij shkrimi. Këto dy dokumente nuk kanë data në fund, prandaj identifikimin e kohës se kur kanë ndodhur këto ngjarje e kam bërë duke përdorur datimet e dokumenteve në faqet pararendëse.

Dokumenti nr. 1 i martesës së Nezim Beratit 1162 hixhri (1748-9):

I kurorëzuari, Nezim Efendi Ibrahim Beu nga Velabishti, i biri i Muhtar (Myftar) Beut, me përfaqësues Beqir Efendiun, dëshmitarë Qendro dhe Dervish Mahmudi.

E kurorëzuara, virgjëresha Ismihani nga Peqini, e bija e Isa Beut, me përfaqësues Molla Ibrahimin, të birin e Bajram Efendiut, dëshmitarë Saliu dhe Abdyli.

Shuma e kurorës 24.000; vetëm njëzetekatërmijë akçe.

Dokumenti nr. 2 i martesës së Nezim Beratit 1165 hixhri (1751-2):

I kurorëzuari, Nezim Efendi Ibrahim Beu nga lagjia Velabisht, me përfaqësues Atullah Myfti Efendiun, dëshmitarë Ali Beu dhe vëllai i tij Ymer Beu, të bijtë e Dursun Beut.

E kurorëzuara, virgjëresha Hatixhe, nga Bobrati, e bija e Hasan Beut, me përfaqësues Dervish Hasanin i biri i El-Haç Ismailit, dëshmitarë Hyseni dhe Ymeri, të bijtë e El-Haç Jahjait.

Shuma e kurorës 60.000; vetëm gjashtëdhjetë mijë akçe.

Lista e objekteve të pajës:

Qyrk trupor (veshje) prej kanavace: 1; dollama prej kanavace: 1; takije prej kanavace: 1; brez prej argjendi: 1; qyrk trupor (veshje) i llojit Hitaj (distrik në veri të Kinës së sotme): 1; dollama e llojit Hitaj: 1; xhybe prej kadifeje: 1; jelek kadifeje: 1; brez me zinxhirë: 1; qyrk trupor (veshje) prej cohe: 1; dollama prej cohe: 1; takije prej cohe: 1; jelek prej cohe: 1.

E konfirmuar.³

Nga përmbajtja e dy dokumenteve, mësojmë se të dhënat zyrtare identitare për poetin janë: emri, Nezim Efendi Ibrahim Bej; emri i të atit, Muhtar (Myftar) Bej dhe vendlindja, lagja Velabisht e cila ndodhet 2 km larg Beratit. Këto të dhëna janë të njëjta në të dy dokumentet dhe nuk bien ndesh me njëra-tjetrën.

Së pari, dua të tërheq vëmendjen mbi mënyrën se si shkruesi i është adresuar poetit. Kemi të bëjmë me një emër të përbërë nga dy pjesë, Nezim Efendi dhe Ibrahim Bej, të cilat diferencohen nga njëra-tjetra edhe nga përdorimi i dy titujve të ndryshëm. Ky është një rast i veçantë të cilin deri më

* Atullah Efendiu, është një person që identifikohet edhe në *Divanin* shqip të Nezimit. Kjo është një çështje që kërkon një vëmendje të veçantë dhe do të jetë objekt i një studimi tjetër.

³ Korresponduesja shqipe për termin e turqishtes osmane *Sahh*.

sot nuk kemi arritur që ta hasim në dokumentacionin osman të kohës. Kjo situatë bën që dhe analiza dhe gjykimi për jetën e këtij poeti të bëhet duke marrë parasysh edhe këto elemente shumë të rëndësishme të identifikimit të tij në kohën kur ka jetuar.

Si *Efendi* (e huazuar në turqisht nga greqishtja bizantine) ashtu edhe *Bej* (e prejardhur nga turqishtja e vjetër) janë tituj civilë me kuptimin “zotëri” të cilat kanë patur një frekuencë shumë të lartë përdorimi gjatë gjithë historisë së Perandorisë Osmane. Mirëpo këto tituj, në varësi të dinamikave dhe fenomeneve socio-kulturore kanë pësuar ndryshime kuptimore duke zvogëluar apo zgjeruar hapësirën e përdorimit. Në shekullin XVIII, do me thënë në kohën kur ka jetuar Nezim Berati, titulli *Efendi* përdorej për të shënuar njerëzit e letrave dhe klerikët, duke i diferencuar ata në këtë mënyrë nga kasta ushtarake.⁴ Kurse përdorimi i titullit *Bej*, lidhet ngushtë me statusin social të individit që e mbante këtë titull dhe përdorej si për klasën e fisnikëve, ashtu edhe për personat që kishin një ndikim dhe autoritet social të caktuar.⁵

Nga dokumenti i parë i martesës, del qartë se titullin *Bej*, poeti e ka trashëguar nga i ati (Muhtar Beu). Kurse *Efendi* është një titull i ri i cili bashkëlidhet me pseudonimin e tij letrar dhe që e ka fituar vetë në sajë të krijimtarisë dhe veprimtarisë së tij si poet. Këtë mënyrë identifikimi e gjejmë të konfirmuar edhe në *Divanin* shqip të Nezimit, në të cilin shprehet qartë se emri i tij është *Ibrahim*, kurse si pseudonim letrar ka zgjedhur *Nezim*:

*Benim mahlasım Nezimdir,*⁶
emërinë e kam Ibrahim.⁷

Në të vërtetë zgjedhja e një pseudonimi letrar nuk është karakteristikë vetëm e Nezimit, por bën pjesë në traditën poetike të shkrimit të Divaneve. Poetët e divaneve, në përgjithësi nuk shkruanin me emrat e tyre personale, por zgjidhnin një pseudonim të cilin e përdornin në poezi edhe si mjet retorik. Ata mund të zgjidhnin emra lidhur me koncepte abstrakte, imazhe apo motive me vlerë të veçantë poetike, por mund të preferonin edhe emra që tregonin origjinën e tyre gjeografike. Kështu poeti shqiptar i shekullit XV, Mesih Prishtina, emrin e ka patur Isa që është versioni Islam i emrit të Jezu Krishtit, kurse pseudonimin letrar *Mesih*. Këtë pseudonim e ka zgjedhur sepse është një

⁴ Bernard Lewis, *Encyclopaedia of Islam*, II:687a, Leiden: Koninklijke Brill NV, 1999.

⁵ M. Fuad Köprülü, “Bey (Beg),” *İslam Ansiklopedisi* II: 579a, Istanbul: Milli Eğitim Basımevi, 1993.

⁶ Varg turqisht: Pseudonimi im është Nezim.

⁷ *Nezim Berati, Divani shqip* – edicioni tekstual kritik Genciana Abazi-Egro, Tiranë: “Toena”, 2009, f. 337.

fjalë që i referohet drejtpërsëdrejti emrit të tij origjinal, pasi në turqisht do të thotë “që ka lidhje me Isain.”

Edhe Nezimi pseudonimin e tij letrar e ka bërë sipas një arsytimi të caktuar të cilin e shpjegon qartë në të dy Divanet e tij shqip dhe turqisht, të cilat kanë mbërritur deri në ditët tona.

Emri Nezîm vjen nga fjala *nazm* me origjinë arabe, e cila ka kuptimin e një vargu poetik të krijuar sipas një metrike dhe prozodije të caktuar, dhe do të thotë tërësia e këtyre vargjeve të shkruara me një harmoni dhe simetri perfekte. Kurse trajta *nâzim*, ka kuptimin e poetit që shkruan mjeshtërisht poezi. Është interesant të vihet në dukje se poeti ka zgjedhur trajtën *nezîm dhe jo nâzim*, duke sjellë në këtë mënyrë në vëmendje artin poetik më shumë se sa poetin që e realizon atë. Në Divanin turqisht, ai madje luan me këto tri fjalë duke krijuar edhe shoqërizime të ndryshme të cilat hedhin dritë edhe mbi mënyrën se si i konceptonte dhe i përdorte ai ato. Më poshtë po jap vetëm dy shembuj të shkëputur nga Divani turqisht i poetit, në të cilat ai arsyeton mbi pseudonimin e tij:

*Ben Nezîmim, dürr-i nazımdan derunum bellüdüir*⁸

(Unë jam Nezimi, është e qartë, shpirti im është plot me vargje si perla)

Şol nazımim ki mahlasım da Nezîm

*Nideyim bu hilkatim ezelden bu.*⁹

(Këto janë vargjet e mia mjeshtërore, pasi edhe pseudonimin e kam Nezim, Sepse këtë talent e kam të lindur) (Theksimet janë të miat, G.A-E)

Përveç kësaj zgjedhja e këtij pseudonim letrar lidhet drejtpërsëdrejti edhe me pretendimet që ai shfaq në poezitë e tij për talentin e lindur dhe mjeshtërinë në artin poetik, duke e diferencuar veten nga poetët e tjerë të kohës. Madje Nezimi në poezitë e tij krahasohet me poetët e mëdhenj të orientit dhe shkon aq larg sa veten e quan Saadiun dhe Urfiun e kohës së tij.¹⁰

Nga ana tjetër, konceptimi shumë i qartë në identifikimin zyrtar të poetit i pseudonimit të tij letrar dhe diferencimi i tij edhe me anë të titullit shoqëruar *Efendi*, dëshmon për njohjen dhe përdorimin e këtij pseudonimi edhe në jetën e përditshme. Kurse përmendja e tij në fillim dëshmon edhe për një dominancë ndaj emrit real të poetit (Ibrahim) dhe kjo është në përputhje të plotë edhe me rendin që vetë poeti përdor në *Divanin* shqip (pseudonimi im është Nezim, emërinë e kam Ibrahim).

Kurse për sa i përket vendlindjes së poetit, këto dy dokumente tregojnë qartë se Nezimi ka qenë nga Velabishti (2 km larg Beratit). Kjo e dhënë

⁸ F. 74a (manuskript, Biblioteka Kombëtare Tiranë, Dr. 6/ 28 D).

⁹ *Po aty*, f. 75/a.

¹⁰ *Nezim Berati ...*, f. 214.

konfirmohet në të dy dokumentet, pa ofruar asnjë kundërshti mes tyre. Përcaktimi i qartë i Velabishtit si vendlindje e tij, i jep fund në këtë mënyrë edhe hamendësimeve të deritanishme mbi vendlindjen e poetit e cila ka qenë në shumë raste dhe përcaktuese edhe në vetë identifikimin e tij.

Problemi i vendit të lindjes së Nezimit ka qenë prezent në literaturën shkencore që me botimin tashmë klasik të Georg Hahnit *Albanesische Studien*.¹¹ Hahni, në të vërtetë ka meritën që është i pari i cili përmend Nezimin në literaturën shkencore, por për shkak të mos njohjes së këtij poeti, të dhënat biografike të paraqitura prej tij janë të pasakta, kurse poezitë e dhëna për ilustrim, jo vetëm që janë produkt i një transmetimi gojor, por me përjashtim të poezisë nr. 8 nuk janë të Nezimit vetë.¹² Kështu Georg Hahni, si vendlindje të poetit jep Përmetin dhe bën me dije se Nezimi është i biri i Ali pashë Frakullit.¹³ Këto të dhëna të Hahnit do të jenë prezente në studimet letrare deri në vitet '30 të shekullit XX.¹⁴

Kurse në vitin 1938 Abdullah Ferhati, duke u mbështetur në një poezi përkujtimore të shkruar pas vdekjes së Nezimit nga poeti Fejzi, bën me dije se Nezimi ka qenë nga fshati Frakull.¹⁵ Abdullah Ferhati nga një përkthim jo i saktë i kësaj poezie, ka nxjerrë që mbiemri i poetit është Nezim, kurse emri i të atit të tij, Ibrahim. Kjo e dhënë është përdorur edhe nga revista gjatë publikimit të *Divanit* shqip (Divani i Nezimit, i biri i Ibrahim bej Beratit). Në të vërtetë, poezia e Fejziut,¹⁶ është i vetmi dokument historik që disponojmë deri më tash, ku emërtimi Frakull përmendet lidhur me Nezimin. Duket se kjo e dhënë e tërthortë historike ka qenë më se e mjaftueshme për studiuesit shqiptarë të gjysmës së dytë të shekullit XX, që poetin ta identifikojnë me mbiemrin Frakulla. Dhe në vitin 1954, në një artikull të botuar për jetën dhe krijimtarinë e këtij poeti në *Buletin e Institutit të Shkencave*, Osman Myderrizi këtë poet e ka quajtur Nezim Frakulla.¹⁷ Vetëm se në punimet e tij dorëshkrim që janë

¹¹ J.G. von Hahn, *Albanesische ...*, f. 142-146.

¹² Për këtë çështje shih dhe Ettore Rossi, "Notizia su un manoscritto del canzoniere di Nezim (secolo XVII-XVIII) in caratteri arabi e lingua albanese", *Rivista degli Studi Orientali*, volume XXI, fasc. II-III-IV, 1946, f. 220; Osman Myderrizi, "Nezim Frakulla", *Buletin për Shkencat Shoqërore*, nr. 4, 1954, f. 56, 58.

¹³ J.G. von Hahn, *Albanesische ...*, f. 142.

¹⁴ Demetrio Camarda, *Appendice al saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Prato: "Alberghetti", 1866, f. 46-50; Alberto Straticò, *Manuale di Letteratura Albanese*, Milano: Urlico Hoepli, 1896, f. 270-272; Gaetano Pettrota, *Popolo, lingua e letteratura albanese*, Palermo: Tipografia Pontificia, 1931, f. 246-247.

¹⁵ Abdullah Ferhati, "Pak dritë mbi jetëshkrimin e Nezimit," revista *Zani i Naltë*, 5, 1938, f. 158.

¹⁶ Kësaj poezie të botuar integralisht nga Abdullah Ferhati në revistën *Zani i Naltë* (1938, nr. 5) deri më sot nuk i dihet baza origjinale e referimit.

¹⁷ "Nezim Frakulla", *Buletin për shkencat shoqërore*, 4, 1954, f. 56-76.

paraqitur për diskutim në Institutin e Shkencave ai fillimisht ka përdorur emrin Nezim Berati. Më pas fjalës Berati i ka rënë sipër me vizë dhe ka shkruar Frakulla. Në trajtën e botuar, vërejmë vetëm ndonjë rast sporadik në të cilin poeti është quajtur Nezim Berati. Ky dualitet shprehet qartë edhe në tekstin zyrtar të *Historisë së Letërsisë Shqipe*, të botuar në vitin 1959 nga Instituti i atëhershëm i Historisë dhe Gjuhësisë. Në vështrimin kritik mbi letërsinë shqipe të shekullit XVIII Mahir Domi shkruan se poeti njihet me emrin Nezim Berati, ndërkohë që kapitulli monografik mbi këtë autor (kap. XII) është emërtuar *Nezim Frakulla*.¹⁸ Në formën Nezim Frakulla do të identifikohet poeti gjatë gjithë gjysmës së dytë të shekullit XX, madje me këtë emër do të përfshihet edhe në *Fjalorin Enciklopedik Shqiptar*, botim i Akademisë së Shkencave.¹⁹ Një përjashtim në këtë drejtim bën vetëm libri *Poezia e bejtexhinjve* botuar në Prishtinë në vitin 1987, në të cilin poeti identifikohet me emrin Ibrahim Nezimi.²⁰ Kjo zgjedhje duket se është një ndikim i drejtpërdrejtë i emrit që Dhimitër Shuteriqi ka përdorur për këtë poet në *Antologjinë e letërsisë shqipe për shkollat e mesme*, botuar më 1955.²¹ Vetë Shuteriqi, në botimet e tij të më pasme do ta përdorë në formën Ibrahim Nezim Frakulla.²²

Pas këtyre të dhënave të reja dokumentare, problemi që shtrohet është se cila do të jetë mënyra e identifikimit të poetit.

Emri Nezim Frakulla, i përdorur në gjysmën e dytë të shekullit XX është një identifikim që bie poshtë si nga vetë krijimtaria e Nezimit, ashtu edhe nga të dhënat e mësipërme dokumentare. Në krijimtarinë e Nezimit si në shqip ashtu edhe turqisht, fshati Frakull nuk përmendet asnjëherë, madje ai nuk aludon as edhe për lidhje të tjera të mundshme me këtë fshat. Vetë konfirmimi zyrtar i Velabishtit si vendlindje e tij dëshmon për pasaktësinë në këtë identifikim.

Në *Divanin* e tij shqip ai e pohon qartë emrin (Ibrahim) dhe pseudonimin e tij letrar (Nezim), kurse veten e identifikon si *Nezimi nga Berati*. Madje në *Divanin* turqisht shpreh në mënyrë të qartë se Berati është “vatani” i tij²³ dhe çdo gjë të tijën e lidh me këtë qytet. Prandaj duke respektuar mënyrën se si poeti ka dashur vetë të thirret, të shprehur në mënyrë të qartë në veprat e tij,

¹⁸ Mahir Domi, “Kultura dhe letërsia shqipe në shek. XVIII dhe në fillimin e shekullit XIX”, *Historia e Letërsisë shqipe*, I, Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës – Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë, 1959, f. 239-254.

¹⁹ “Nezim Frakulla”, *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë: 1985, f. 287.

²⁰ Hajdar Salihu (ed), *Poezia e bejtexhinjve* Prishtinë: “Rilindja”, 1987, f. 133.


²¹ Dhimitër Shuteriqi, *Antologji e letërsisë shqipe - për shkollat e mesme*, Botim i Ministrisë s’Arsimit dhe Kulturës, Tiranë: 1955, f. 64.

²² Dhimitër Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Tiranë: Shtëpia Botonjëse “Naim Frashëri”, 1965, f. 76.


²³ F. 9b. (manuskript, Biblioteka Kombëtare Tiranë, Dr. 6/ 28 D).

është e drejtë dhe etike, madje dhe shkencërisht korrekte që ky poet në letrat shqipe të zërë vendin me emrin Nezim Berati.

Genciana ABAZI-EGRO



Apendiks 1: Dokumenti i martesës së parë të Nezim Beratit 1162 hixhri (1748-1749)



Apendiks 2: Dokumenti i martesës së dytë të Nezim Beratit 1165 hixhri (1751-1752)

